

Yzedin  
Hima

BIBLIOTEKA

85H-1  
ff 65

# HOMAZH ERES

Poezi

EBB

Ent Botues Berat  
1994

BŞH-1  
H 65

YZEDIN HIMA

# HOMAZH ERËS

poezi



SHTEPIA BOTUESE "JANI VRUHO" Berat  
1994

**Redaktor: Balil Gjini**

**Piktor: Arben Golemi**

**Korrektor: Gent Arianiti**

*Piktura e kopertinës, nga Patrick DAMIOLINI*

**Botues: Xhevahir Lleshi,**

**Shtëpia Botuese "Jani Vruho" Berat**

**Adresa: Pranë Muzeut Historik, Berat**

**Tel. (+355 623) 2244**

**(+355 623) 2486**

**U fut në shtyp në maj 1994**

**Doli nga shtypi në qershor 1994**

**Të gjitha të drejtat i rezervohen botuesit**

**Realizimi në kompjuter Firma FIDIA & MIRON**

## Ndarja

Këtë natë  
jam peshk i kapur në rrjetë  
dhe përpëlitja e tij mbi zall.  
Jam bredhi i lartë  
me sharrën në trup  
Jam bora e shkëmbit  
nën shiun përvëlues  
Jam dre i mbërthyer  
dhe klithma pa shpresë  
Jam kallam i vëtmuar  
nën erën e marrë  
Këtë natë  
Ti ike larg  
Uji më ngriu në pellgjet e syve  
brenda tyre  
portreti yt i krisur.

## Sytë e maces

Shqisat janë tendosur si hark.  
Nga muret  
Gurët lëshojnë sythe të gjelbër.  
Hapat e saj  
Ndihen që larg,  
Xhamat e dritareve  
si liqenet në dimër ngjethen  
Dera fërgëllon si vajzë e virgjër  
Nga pritja për t'u hapur  
Macja më shikon me sy të çuditshëm  
E dëboj, e godas, e qortoj  
i lutem të iki,  
ajo nuk lëviz.  
Ngjesh putrat mbi parvaz  
e më vështron në sy  
Ajo vjen  
me hapa bore

Shikimi i maces më tmerron.  
pastaj gjithçka shkrihet, rimet  
edhe muret me sythet e gjelbër  
edhe xhamat si copa valësh  
nën një puthje të gjatë  
të prerë nga mjaullimat e maces.

## **Homazh erës**

Pemët kanë harruar të heohen  
dhe trungjet kanë vënë dhjamë  
pemët qëndrojnë drejt si qirinjtë në kishë  
dhe degët krahë të tepër i kanë.  
Zogjtë përtojnë të fluturojnë  
me milingonat shëtisin në bar  
dhe krahët i hëqin zvarrë.  
Floket e vajzave më nuk flladiten  
të mbulojnë intimitetin në buzë.  
Gjithçka u tha e mbeti postulat  
edhe nata, edhe dita, edhe pluhuri në rrugë.  
Lumi është kthyer në një pellg vaji  
dhe zvariset në shtratin e vjetër  
pa një dallgë, pa një rrudhë.  
Njerëzit i krehin flokët një herë në javë  
dhe gurët janë fiksuar si pllaka varri.

Gjithçka ka zënë vend si në një manastir  
ka kohë që nuk fryn erë  
ka kohë që mungon sfida e erës.  
Njerëzit ecin ngadalë në homazhin e erës.

**1987**

## **Lumenjtë i dua**

Lumenjtë i dua ..  
edhe ujëpaket edhe valëshumë  
Po turbullohem nga turmat  
që lumenjtë imitojnë  
kur dalin në rrugë  
Lumenjtë dinë ku shkojnë  
Lumenjtë dinë nga rrjedhin  
Dhe para detit  
nuk kanë asnjë kompleks,  
Turmat e irrituara,  
Turmat pa shtrat  
Që nuk kanë një burim  
Që nuk synojnë një det  
Verbërisht si ai nxënësi i dobët  
kopojnë lumenjtë.

## Zogjtë ikën larg

Zogjtë ikën larg  
dhe kupa e qiellit u kris.  
Degët e gjelbëra një nga një dhanë shpirt.  
Mbeta një trung si shtrat i tharë lumi  
Ku vetëtimat takohen dhe bëjnë dashuri  
Foletë bosh, braktisur nga zogjtë  
kupa iluzionesh prehen nën shi.  
Zogjtë ikën larg.  
Kope milingonash vërvshuan nëpër shtat  
Kotësisht zbresin poshtë  
idiotsisht ngjiten lart  
Tani po pres vetëtimat  
miket e mia të vtmisë  
Një ditë të shprazin flakën, të ndezin zjarrin  
Të djegin strëmundimin e kotë të insekteve  
Nga poshtë lart

Nga lart poshtë  
Dhe trungun vorrezë me rradhët kohore  
Që asgjë nuk thanë  
Që asgjë nuk thonë  
Që asgjë s'do të thonë.

## Mëngjes i thyer

Copra qelli kanë rënë mbi asfalt  
Vajzat vrapojnë e qeshin si të marra  
Me këmbët e përgjakura  
nga qelqet e kaltra.

## **Fjalët e zhveshura**

U zhveshën fjalët  
Nga nuditeti i tyre i prekshëm  
ajri u skuq.  
Fjalët nudo tallen me semantikën  
dhe fluturojnë në erë  
Si puplat e pëllumbave të trembur.  
Kuptimet e gjera  
fjalët i flakën një e nga një  
si palltot, bluzat; këpucët e rënda  
që rëndoijnë fort në pragverë  
Fjalët u thanë të lira, të lehta  
si të linjtat e vajzave të virgjëra.

## Këtu gjithçka është e rrafshët

Këtu gjithçka është e rrafshët  
edhe fjala  
edhe mendimi  
edhe dëshira.

Të rrafshta si reliivi i këtij vendi.  
Pemët

shtëpitë  
maja më e lartë e fushës - bregu  
dhe njerëzit, sidomos njerëzit  
këtu janë të niveluar.

Dhe s'ka asnje rrezik animi  
dhe s'ka asnje rrezik rrëshqitjeje  
dhe s'bëhet fjalë kurrë për përbysje.

Këtu gjithçka është e sheshtë  
edhe grindja  
edhe pendesa  
edhe dashuria  
Ka kohë që jetoj këtu  
dhe kam humbur përmasat.

## **Ajri më vjen pas**

Unë jam  
çfarë i mungon këtij mëngjesi  
edhe terri edhe drita.

Unë jam  
çfarë i mungon kësaj rruge  
edhe hapat edhe heshtja.

Unë jam  
çfarë i mungon këtij guri  
edhe bari edhe rrokullisja.

Unë jam çfarë i mungon kësaj porte  
edhe hapja edhe trokitja.

Unë vrapoj  
Të mbush mungesën e sendeve  
Ajri më vjen pas.

## **Sot njerëzit dolën të lumtur**

Eshtë ditë feste

Dhe njerëzit dolën në rrugë  
brenda kostumeve të rinj  
të varur në kravata të reja  
me buzëqeshje të vizatuara në buzë.

Sot është ditë e shënuar  
Kalendarët i urdhëruan njerëzit

Veçanërisht sot të jenë të lumtur.  
Ata fshinë pluhurin e kalendarëve  
dhe dolën në rrugë.

Qyteti ngazëlleu nga lumturia  
e banorëve të tij,  
të cilët nuk dinin ku t'i mbanin duart  
të hutuar befas nga lumturia.

## **Pylli pozon**

Pylli pozon  
sikur është pyll  
dhe drurët i humbi një nga një  
Malet, kodrat, fushat  
humbën kuptimin  
dhe u kthyen në flamuj të hiçit.  
Njerëzit ditë pas dite harruan të jenë njerëz  
ishin veç krijesa të lumtura  
dhe vlenin sa një fletë lavdërimi.  
Deti u shpall armik  
Fillimi dhe fundi i një shprese të tretur.  
Lumenjtë: Po, ata rridhnin  
dhe na kujtonin se dikur në këto vise  
jetonin edhe njerëz.

## Kam ftohtë

Sa herë nis tē bjerë shi rrebesh  
më lind dëshira  
tē kapem pas rigave tē shiut  
dhe tē ngjitem lart, lart  
për tē ndëshkuar retë.  
Nga dëshira e marrë  
rigat e shiut u përplasën në kryet e mi  
dhe m'i përgjakën mendimet.  
I rrahir në shiun që bie nga lart  
i fyer nga demoni i reve gri  
e ftohta më shkoi deri në asht.  
Kam ftohtë; kam ftohtë.  
Më shumë se nga shiu i akullt  
Nga rigat e fyerjes  
që përplasen mbi kryet e mi  
mbi supe tē brishta, mbi degë tē gjelbra  
mbi shpirtra tē ndjeshëm

si mbi asfalt.

Kür është kohë e bukur  
mjegulla e reve zbrret poshtë  
dhe na përqafon  
deri në tallje.

## Pranvera

Prilli me gishtat e erës  
mollën e trazon.

Nga trupi i saj i xhveshur  
është i dehur.

Ajo përflaket në mijëra burbuqe  
e mezi pret të gjethojë  
hiret për t'i fshehur.



## **Njeriu i dobishëm**

Ai është i dobishëm  
sí një gozhdë a sí një vidë  
që gjithmonë mungon diku  
Ai është i dobishëm  
sí një manekin në market  
ku vizitorët ndalojnë hapat një çast.

Ai është i dobishëm  
sí një dordolec në mes të arës  
që u fut tmerrin zogjve.  
Qëllon shpesh që ai të ngjitet tribunave  
për të bërë fotografji  
a pér të marrë dekoratë.  
Ky njeri a shpend i dobishëm  
nga ne njerézit a shpendët grabitqarë  
Dallon qartë.

## Nata

Nata me hapat e maces afrohet ngadale  
duke u lëpirë në strehët e mëhallës  
Të dehurit me të fashojnë mallin dhe brengat  
Të dashuruarit paketojnë me të opinionet  
për t'i nisur të nesërmien sa më larg.  
Afrohet e shtriqet e mpihtë nata  
té marret flene në krahët e saj  
té famshmit, dehur nga drita dhe lavdia  
tërë natën pijnë terrin dhe mërzinë.  
Nata e pushtoi gjithësinë apo gjithësia natën  
gjithësia në natë fsheh fytyrën dhe dobësitë  
Në mëngjes fshesarët me fshesat e gjata  
fshijnë copa terri, mendime të vrara  
dhe dita shfaqet e virgjër sërisht.

## Poezi që nuk u shkrua kurrë

Në dorën e shtrirë të lypsit  
unë jam krahu i thyer i zogut  
Në hapat e nxitura të prostitutës  
unë jam hijeshia e saj e ikur,  
në trishtimin e vajzës në park  
unë jam dashuria e saj e humbur.  
Në letrën që po niset larg  
unë jam malli i saj i bardhë  
Në gjestin e vrasësit që u fsheh  
unë jam pendimi i tij i zi  
Në hipokrizinë e politikanit në TV  
unë jam fëmijëria e tij e dliërë  
Në librin me poezi që u botua  
për krahun e thyer të zogut  
për hijeshinë që s'vjen më  
për dashurinë e humbur  
për mallin e bardhë  
për pendimin e zi  
për fëmijërinë e dliërë  
unë jam poezia më e mirë  
Që nuk u shkrua kurrë.

## **Portat e lagjes së vjetër**

Rrathët kohorë  
ka kohë që janë zbehur  
Në portat e hirta  
të lagjes së vjetër.  
Plakat e mëhallës  
i shtyjnë ngadalë  
I trëmb rënkim  
i shpirtit të portave  
vajtim i trishtë  
i drurit të vjetër  
për nuset e reja  
që u bënë plaka.  
Portat e vjetra, portat e rënda  
Me gjurmë duarsh, trokitje të hershme  
Me grishin t'i hap  
Si libra të rrallë.

## **Ma vodhën lumin e fëmijërisë**

Ma vodhën lumin e fëmijërisë sime  
Nuk e di  
Në iشا fjetur apo zgjuar  
Dhe mbeta pa udhë në mes të udhës  
Dhe mbeta pa portë në prag të portës  
Aty ku fryjnë erëra të ngarkuara me pluhur të zi.  
Ma vodhën lumin e të djeshimes sime  
dikush i vuri frerët dhe poshtë ngau me trok  
Në udhëkryq mbeta, semafor i kohës së re  
të tjerëve u them ndal,  
kalo,  
kujdes,  
kalo majtas,  
kalo djathtas;  
Lumi diku shkon, diku mbetet, diku rrjedh  
Lumi i përgjakur  
i fëmijërisë sime të trishtë.  
Sot kam mall të jem  
degë e njomë rrapi  
që fërgëllon mbi lumë.

## Hutesë

Një grua e bukur kalon në rrugë  
e grimca nga kurmi i saj  
Shpërndan në eter  
Një plaku që kalon pranë saj  
i bie shkopi por për çudi  
nuk përkulet,  
zgjatet tek një mimozë.  
dhe më duart eshtake  
lulet i përkëdhel.

## **Shpirtin se pata sa qielli**

Befas e dashur  
si dallëndyshe  
hyre në qiellin e shpirtit tim.  
Ndër harqe drite dhe kaltërsie  
hapësira kërkoje pa mbarim.

Falmë, o Zot hapësira shpirti  
dallëndyshe e bukur  
të mos thyeje krahët në mur e terr  
ndryshe ajo do t'më braktisi  
si shpirti braktis kurmin për tmerr.

Një ditë  
e dashur ti shtegtove  
në një tjeter qiell, në një tjeter hapësirë  
qielli shpirt e shpirti sa qielli  
për mua mbeti veç një dëshirë.

Herë - herë trokas në portat e ajrit  
Reth meje veç ajri u drodh  
këmbanat e hiçit  
kumbojnë në një hapësirë bosh

## **Redaktim i thjeshtë**

*... Jotja do të jetë Bota, me çka brenda  
dhe Burrë do të jesh, o biri im.*

*RUDYARD KIPLING*

Të rrish me vite të tëra me spiunë  
pabesish të spiunohesh dhe të mos jesh spiun.

Të rrish me vrasës  
të vritesh çdo ditë e nga pak  
dhe vrasës të mos bëhesh kurrë.

Të rrighthesh nga hipokritë  
dhe nga gjithë veset  
hipokrizinë të urresh më shumë.

Të rrish me gënjeshtarë, të besosh te gënjeshtra  
dhe si i gënjer të mos gënjesh kurrë.

Të ngresh kështjella  
dhe të nesërmen i hutuar nder gërmadhat e tyre  
serish të nisësh të njëjtën punë.

Një jetë të tërë  
një jetë pa fund  
dhe Bota s'është imja, s'është jotja  
e tyre është gjer në fund.

## **Ditët si fletë të bardha**

E uritur erdhi pasdite pulëbardha  
Klithi dhe u fut mes ditëve të mia  
dhe ditët nisi t'i këpusë një nga një  
deri tek fleta e fundit e kalendarit.

Midis ditëve

Sa shumë ditë si fletë të bardha  
Ditë të ikura ende pa jetuar  
Ditë të fshehura thellë në vete  
si margaritarë të rremë  
apo si xhamë të thyer në arkë  
që kurrë s'do reflektojnë pejsazhet në dritat.

## **Sa shumë gjethe kanë rënë këtë natë**

Sa shumë gjethe kanë rënë këtë natë  
mbi tokën e ngjethur që u përgjak  
pastaj nisi të bjerë bora e parë  
lehtë - lehtë si fashat mbi plagë.

## Vizitë kortezie

Shpirti im ka kohë i sëmurë  
sot dhe unë  
i shkova për vizitë.  
Ai më ledhatoi duart  
dhe u përlot për rininë time  
që po ikën.  
Pastaj nisi të lexojë  
poezitë që i çova si dhuratë.  
Një infermieri e re  
erdhi t'i ndërrojë plagët  
ndërsa unë ktheva kokën nga lumi  
si vrasësi që fsheh një mëkat.  
Pastaj shpirti më tregoi për vizitorët.  
Kishin ardhur rrugët  
dhe i kishin sjellë hapat e të dashurës  
shpirti im që trondit tur shumë  
nga zbehja e hapave në rrugë.  
Kur ika  
ai më përcolli deri tek porta  
duke u dridhur nën fashat e bardha.

## **Struga**

Çatitë me qeramidhe të kuqe  
çati të pjerrta dhe mure te bardhë  
Qyteti zhytet në gjol e del në breg  
dhe shpupuris krahët si pulëbardhë.

Në mbrëmje zjarr merr liqeni  
kaltërojnë shtëpitë pranë  
nimfat dalin nga uji dhe shëtisin netëve  
përqafuar me djemtë si në përrallë.

## **Vajzat e Strugës**

E pinë liqenin vajzat e Strugës  
nga xhelozia për nimfat.

E nimfat mërguan larg  
rrjedhave të Drinit.

Nuk e di ku t'i hedhi rrjetat  
per të peshkuar kujtimet.

Ndoshfa tek sytë e liqentë  
te vajzave të Strugës

## Shiu

Ketë mëngjes pikat e shiut  
trokitën fort mbi asfalt  
Njerëzit u fshehën strehëve  
Njerëzit u mbrojtën nën çadra, mushama.  
Ketë mëngjes pikat e shiut  
goditën fort mbi çati, mbi njerëz  
Njerëzit sërisht i mbrojtën kokat, kërrusën shpinat  
Fshehën ftyrat e bukura, syte e trishtuar  
Veç ndërgjegjen e lanë në shi  
Dhe pikat goditën fort e fort  
Shpirtrat e mbetur nën shi  
Shpirtrat e lagur pa çati  
Njerëzit u fshehën.  
Por shpirtrat lakuq protestojnë  
në asfalt, nën kanizhiket e shiut

## **Ajo vajzë ka pirë dritën**

Kur e pashë atë vajzë  
në sy e shpirt më vrau drita  
kur u njohëm  
skutat e errta tek unë  
morën dritë  
dhe unë njoha veten thellë e më thellë  
më ndjeh, o Zot  
që prej saj u largova me tmerr.

## **Shpirtrat tanë takohen fshehur**

I përzumë ditët  
me fjalët  
puthjet  
mallin.  
Çnjerëzore  
si shpend të plagosur  
i strukëm në vete.  
Befas u bëmë të panjohur.  
Netëve,  
Zgjohemi bosh  
me shpirtëra të braktisur  
nuk e dimë se ku,  
Mëngjeseve  
të lodhur, të trishtuar meditojmë  
kur takohen vallë shpirtrat tanë netëve  
Ku?

## Janë larg e s'vijnë dot

Bashkë me të tjerët  
Skeletet dolën në rrugë  
me kafka të dënuara të qeshin përjetësisht  
Oratorët bërtasin tribunave:  
S'ka më tela, poshtë telat.  
Dhe telat u kthyen në fjalë.  
Dhe gardhi u ngrit sërisht  
Brenda gardhit të fjalëve  
Kafkat,  
Me skeletet e shpuara nga plumbat  
kërcejnë rep, kërcejnë rrok.  
Frika u vra, thonë oratorët.  
Po nga kush?  
Plumba më s'ka.  
U shkrinë e u bënë shkronja  
Dhe mbushin gazetat çdo ditë  
Ca skelete të vjetër  
të humbur larg, të tretur  
Diç duan të thonë  
Diç duan të kujtojnë  
Po janë larg e s'vijnë dot.

## **Telefonata e fundit**

Formoj numrin 2 ... 5 ...

Heshtja si insekt zukat ndër tela

Eshtë pësore aspak kompromentuese

Formoj numrin .... 9 ...

Heshtja si gur midis dhembëve

Heshtje si një procesion.

Një zë i largët

Një zë i lagur

dhe telat dridhen

dhe telat ftohen

edhe telat ngrijnë

zëri i saj

i revolton

E dashur keni harruar ...

Një unazë?

Një perlë?

Nuk i dua, mbaji  
si relikë a si kujtim.  
E da... e panjohur keni harruar  
diçka më të vyer se një unazë apo perlë  
keni harruar shpirtin tuaj të bukur  
dhe unë s'di ç'të bëj me të.  
Heshtja dhe zëri kthehen në tela  
E telat turfullojnë  
Me zëheshtjen sipër  
Me zëheshtje si gjemba.

## **Pejzazh i moçëm shqiptar**

Një burrë ecën hipur mbi kalë  
fundosur në xhufkat e velenxës  
me ornamente kuq e zi  
gruaja e re dhe qeni  
e ndjekin pas me besnikëri.

## Në doganë

Këtu udha merr fund  
Këtu nis një udhë pafund  
Fundrrugë që pret e përcjell njerëz  
Me portën e rregullit a të mosbesimit në mes  
Pasaportat në duar si kafazë ëndrrash  
Shtrënguar fort  
Prej frikës së braktisjes së ëndrrës  
të burgosur në kafazin pasaportë  
Doganierët kontrollojnë pasaporta  
Vënë vula, grisin viza  
dhe ëndrrat marrin krahë, përpëliten  
dhe vdesin si zogj të vrarë  
nën këpucët e rënda të doganierëve  
Zogjtë nga pullazet e doganave  
vështrojnë njérëzit  
dhe fluturojnë lirshëm ndër dy anët e të njëjtit qiel  
megjithëse s'kanë pasaportë.  
Fluturojnë dhe në qiel  
vizatojnë harqe ironie.

## **Shpirrat e xhveshur**

Mbi rërën e plazhit shpirrat prehen  
duke hyrë në mëkatet e vjetra - guacka  
leshterikë u bëjnë hije, u fshehin plagët  
Ndërsa peshqit u bëjnë shoqëri  
shpirrat e xhveshur hyjnë e dalin në ujë  
Kripa e detit djeg mbi plagët mëkatare.  
Vrapojnë të lemerisur shpirrat drejt rërës  
dhe fshihen fatkeq në guacka.  
I bren vëtmia, i bren mëkati  
ulërima e tyre brenda guackave  
Peshqit i bënë të shkrihen gazit  
shpirrat e vegjël djegur nga rëra  
Shpirrat e xhveshur përvëluar nga kripa  
dalëngadalë vdesin.  
Mëkatet kthehen sërisht në të tjera guacka.  
dhe brenda tyre  
Nga miliona guacka  
Nga miliona shpirtra të xhveshur  
Një shpir fatlum  
kthehet në margaritar.

## **Kjo grua u ngrit mbi çdo fyerje**

Aj vdiq në burgun e zi  
ajo mbeti degëz e njomë në kujtimin e tij  
pranë varrit të imagjinuar  
Ajo u ndez qiri e u tret pikë - pikë  
dhe për 40 vjet nuk u shkri.

Sot,  
bashkë me miqtë e burrit të vrarë  
edhe vrasësit erdhën për ngushëllim.  
E përhumbur, larg çdo fyerje  
Ajo shikon udhën e thinjur  
ku lotët bien  
e bëhen tela me gjemba.

## **Pejsazh**

Dritat e mbrëmjes Beratin  
e rritin e dyfishojnë në lumë  
qyteti me zambakët e valëve  
niset drejt detit për udhë.

Pikëzojnë të kuqtë karafilat  
mbi kalldrëmet e bardhë në dyer  
me siguri ngjiten lart në hapësirë  
për të formuar netëve yje të tjerë

Qyteti me shtat të gurtë  
me legjenda, të sotme dhe ëndrra  
qëndron mbi rrëpirat e s'rrëzohet kurrë  
me spirancën e hedhur ndër zemra.

## **Eshtë kohë pendese**

*Sipas T. Eliotit.*

Era

i theu këmbanat këtë mëngjes  
midis ëndrrës, jehona e këmbanave  
theu cipën e akujve  
dhe u përcoll larg.

Shpirrat lakuriq u drodhën  
e mbërdhinë fort këtë mëngjes.

Era

i theu këmbanat  
midis jetës dhe vdekjes  
shpirrat u drodhën  
midis krimit dhe mëshirës  
shpirrat u lodhën.

Eshtë kohë pendese  
për shpirrat e lerosur

Eshtë kohë ringjallje  
për shpirrat e varrosur.

Era i tundi fort këmbanat  
dhe theu cipën e akujve.

\*\*\*

Ne  
edhe dje  
edhe sot  
jemi nisur për udhë  
kapur prej dore me vdekjen  
me udhërrëfejësen tonë të vjetër  
Me të kemi nisur të bëjmë dashuri  
Dhe vdekja me ne ka mbetur shtatzanë  
Ne dashavdekës të krisur  
Preferojmë më shumë të vdesim  
se sa jetën ta zbulojmë.  
Në udhët tona nuk fryn erë  
ndihet frymëmarrja e vdekjes  
Në udhët tona nuk ka pemë  
Po drurë të zinj të heshtjes  
Ne dimë të nisemi për udhë  
Se ku do të mbërrijmë nuk e dimë  
të pluhurosur udhëve të botës  
fatin tonë në fytyrë e pështyjmë  
Ne i harruam emrat tanë

grenarinë grisëm dhe bëmë brekë  
Që bota të mos na shohë zbuluar  
Flemë rrallë, nën ura e basifonde  
shpesh qëllon të mos çohemi përsëri  
Por arkivolet e bukura janë gati  
Për të na kthyer në Shqipëri  
Ne jemi nisur për udhë  
se ku do shkojmë  
as vetë s' e dimë  
Ne jemi eksploratorë  
të jetës dhe vdekjes  
dhe dje  
dhe sot  
edhe  
nesër.

## Në çdo rast ai besoi

Dikush tha:

E vërteta është ky gur  
Ai besoi dhe me gurin shpatullave  
u nis për udhë.

Dikush tha:

Ky gur është mallkjm.  
Ai sërisht besoi  
dhe gurin e ktheu në pllakë varri.

Dikush tha:

E vërteta është ky lumë.  
Natyrisht ai besoi  
dhe në lumë u hodh pa hezitim.  
Tek varri i tij mbi pllakën e hirtë

Dikush shkroi:

“Ky besoi në çdo rast”.

## Lënda

Ndarja	3
Sytë e maces	4
Honiash erës	6
Lumenjtë i dua	8
Zogjtë ikën larg	9
Mëngjes i thyer	10
Fjalët e zhveshura	11
Këtu gjithçka është e rrafshët	12
Ajri më vjen pas	13
Sot njerëzit dolën të lumbur	14
Pylli pozon	15
Kam ftohtë	16
Pranvera	17
Njeriu i dobishëm	18
Nata	19
Poezi që nuk u shkrua kurrë	20
Portat e lagjes së vjetër	21
Ma vodhen lumen e fëmijërisë	22
Hutesë	23

<b>Shpirtin s'e pata sa qelli</b>	<b>24</b>
<b>Redaktimi i thjeshtë</b>	<b>25</b>
<b>Ditët si fletë të bardha</b>	<b>26</b>
<b>Sa shumë gjethë kanë rënë këtë natë</b>	<b>27</b>
<b>Vizitë kortezie</b>	<b>28</b>
<b>Struga</b>	<b>29</b>
<b>Vajzat e Strugës</b>	<b>30</b>
<b>Shiu</b>	<b>31</b>
<b>Ajo vajzë ka pirë dritën</b>	<b>32</b>
<b>Shpirrat tanë takohen fshehur</b>	<b>33</b>
<b>Janë larg e s'vijnë dot</b>	<b>34</b>
<b>Telefonata e fundit</b>	<b>35</b>
<b>Pejsazh i moçëm shqiptar</b>	<b>37</b>
<b>Në doganë</b>	<b>38</b>
<b>Shpirrat e xhveshur</b>	<b>39</b>
<b>Kjo grua u ngrit mbi çdo fyerje</b>	<b>40</b>
<b>Pejsazh</b>	<b>41</b>
<b>Eshtë kohë pendese</b>	<b>42</b>
<b>***</b>	<b>43</b>
<b>Në çdo rast ai besoi</b>	<b>45</b>



**Copra qelli kanë rënë mbi asfalt  
Vajzat vrapijnë e qeshin si të marra  
Me këmbët e përgjakutra  
Nga qelqet e kaltra....**

### **YZEDIN HIMA**

**U lind më 25 dhjetor 1955,  
Ka kryer studimet e larta për gjuhë letërsi,  
punon drejtor i Qëndrës Kulturore - Berat,  
Ky është libri i tij i parë.**